SI PUNOI ENVER HOXHA PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË POPULLIT

(VITI 1945)

S'kishin kaluar ende as 9 muaj nga dita e çlirimit të RPSH-së dhe qeveria e drejtuar prej Enver Hoxhës kish kryer tashmë një varg punësh të rëndësishme në fushën e shëndetësisë. Unë po sjell këtu një pjesë nga raporti i mbajtur prej tij në Sesionin e Tretë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.

1.“Për mbrojtjen e shëndetit të popullit janë arritur suksese të kënaqshëm. Në gjithë (RPSH-në) kemi 13 spitale të mëdhenj civilë me 1700 shtretër. Përpara çlirimit kishte vetëm 800 shtretër në spitalet civilë. Në 7 nga këta spitale bëhen operacione kirurgjikë dhe ka një shërbim kirurgjie të organizuar mjaft mirë. Në të gjitha qendrat ku ka mjekë, bëhen dhe shërbime të organizuar ambulance dhe infermirie. Seksionet e shëndetësisë në prefektura e nënprefektura të mëdha kanë organizuar ekipe mjekësorë ambulantë për krahinat dhe katundet e largët nga qendra. Këta ekipe kanë dhënë rezultate të mirë, sepse shpien kujdesin mjekësor dhe barërat jo vetëm në krahinat më të largëta, por edhe në katundarët e varfër e të këputur nga sëmundjet. Çdo muaj ekzaminohen dhe kurohen në këtë mënyrë me mijëra të sëmurë. Në bazë të ligjit të mobilizimit civil, mjekët dhe

gjithë personeli që merret me punë shëndetësore, janë ndarë në qendra të ndryshme, sipas nevojavet të shëndetësisë. Kundër malarjes dhe për të mbrojtur e kuruar popullin është organizuar një luftë sistematike kundër larvavet të mushkonjavet anofel, si edhe kurimi sistematik. Janë bërë bonifikime në shumë qendra me rëndësi, është ndarë një sasi prej 7 milionë kokrra mepakrinë, si dhe shumë kininë. Me masat urgjente të marrura nga organet e shëndetësisë janë luftuar me sukses tifua ekzantematike dhe abdominale që rrëzikonin jetën e popullit. Me mijëra vetë u sëmurën nga këto sëmundje të rrëzikshme, me mijëra u shpëtuan nga vdekja. Viktimat kanë qenë të pakta. Nga statistikat që kemi deri tani, në gjithë (RPSH-në) kemi pasur 52 të vdekur nga tifua ekzantematike dhe 45 nga ajo abdominale.

Ministria e Shëndetësisë është duke organizuar një qendër antituberkulare në Korçë, ku do të shtrohen të paktën 200 të sëmurë. Kjo qendër, që po krijohet, ka më tepër karakter kurativ se sa profilaktik. Po organizohet shkolla e

infermirëvet, e cila do të ketë 120 nxënës që do të diplomohen brenda një viti. Po organizohet në baza të reja sektori i higjenës dhe i profilaksisë, sektor me shumë rëndësi për të ardhmen e vendit tonë.

E dimë se s'është aspak e mjaftë sa kemi bërë në këtë lëmë veprimtarie, e dimë se me qindra fshatra vuajnë për doktorë, infermierë dhe barëra. Jemi në korrent të kërkesavet të drejta të popullit dhe përpiqemi me çdo mjet dhe brenda mundësivet tona t'i përmbushim. Shumica e doktorëvet tanë me ndërgjegje i janë përveshur punës, punojnë ditë e natë pa u lodhur dhe shumë herë në kondita të vështira materiale, po ata janë njerëz me zemër dhe e kuptojnë situatën, e kuptojnë që duhen bërë sakrifica. Ne dëshirojmë që edhe ajo pakicë shumë e vogël e doktorëvet, që punojnë me frymë të vjetër, të jenë realistë dhe të ndërgjegjshëm, se e drejta njerëzore nuk i lejon të luajnë me shëndetin dhe me mjerimin e popullit. Qeveria u ka bërë thirrje të gjithë doktorëvet shqiptarë të diplomuar që ndodhen jashtë Atdheut, të kthehen sa më parë në (RPSH), se detyra i thërret t'i shërbejnë popullit të tyre.Thirrja jonë, sigurisht, do të dëgjohet nga djemtë me zemër dhe të mësuar të popullit që në momentet më kritikë nga konditat e luftës patën fatin e keq të ndodhen jashtë Atdheut. Ata do të kthehen të zënë vendet e tyre në përpjekjen e madhe që bën populli ynë." (26 shtator 1945, vep.3, f.115-117)

Dhjetë vjet më vonë e në vazhdim

2."Një tjetër tregues i rëndësishëm i Partisë e i shtetit për rritjen e mirëqenies materiale dhe kulturore të nëpunësvet është zgjërimi i aktivitetit shëndetësor gjatë këtyre viteve. Numri i spitalevet dhe kapacieti i shtretërvet, në krahasim me vitin 1950, është rritur 114,3 për qind. Janë ngritur 57 maternitete lokalë dhe është rritur numri i të shtruaravet në repartet e maternitetit në 169,4 për qind, në krahasim me vitin 1950. Numri i sanatoriumevet, i dispanserivet, i poliambulancavet ose i ambulancavet dhe i çerdhevet ditore që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë, është rritur respektivisht 125 për qind, 125 për qind, 139,6 për qind dhe 320 për qind.

Gjatë katër vitevet të pesëvjeçarit të parë kanë pushuar në shtëpitë e pushimit të punëtorëvet dhe të pionierëvet 23995 punëtorë e nëpunës dhe 29540 pionierë. Gjatë këtij viti do të pushojnë 7000 punëtorë e nëpunës dhe 8000 ponierë të tjerë.

Sigurimet shoqërorë-shtetërorë janë një fitore e madhe e klasës punëtore dhe një mjet i rëndësishëm për rritjen e mirëqenies së saj. Sigurimet shoqërorë u garantojnë punëtorëvet e nëpunësvet 18 lloje shërbimesh, pensionesh e ndihmash të ndryshme siç janë shpërblimet në rast sëmundjeje e aksidenti në punë, barrë e lindje, pensione pleqërie etj.

Fondet e mëdhenj të sigurimevet shoqërorë që shtohen çdo vit me kujdesin e Partisë, të qeverisë dhe me punën e vetë punëtorëvet për shtimin e prodhimit, influencojnë në ekonominë individuale të punëtorëvet dhe në të ardhurat e tyre. Në krahasim me vitin 1948 fondet e shpenzuar në vitin 1954 nga sigurimet shoqërorë kanë qenë katër herë më të mëdhenj. Gjatë kësaj periudhe (1948-1954) punëtorët e nëpunësit kanë përfituar prej tyre 1 miliardë e 329 milionë lekë. Buxheti i sigurimevet shoqërorë për vitin 1955 arrin në 250 milionë lekë ose 15,5 për qind më shumë se sa u shpenzuan për sigurimet shoqërorë në vitin 1954." (17 qershor 1955, vep.12, f.461-462)

3."Gjatë planit të katërt pesëvjeçar do të merren masa për zgjërimin dhe për përmirësimin e shërbimit shëndetësor, duke synuar që në vitin 1970 të ketë një mjek për çdo 1200 frymë. Një kujdes i veçantë do t'u kushtohet ruajtjes së shëndetit të fëmijëvet, masavet profilaktike, përmirësimit të higjienën, veçanërisht në fshat." (1 nëntor 1966. Vep.34, f.93)

4."Ne e kemi shtruar edhe herë të tjera çështjen e pastërtisë, po realitetin duhet ta shohim drejt në sy. Është fakt i hidhur që në disa fshatra të malësivet tona të Veriut nuk e përdorin akoma sa duhet sapunin. Atje ka njerëz që nuk e lajnë trupin. Shoqja Haxhire Brahja na ka treguar se disa të reja vullnetare, të ndikuara nga zakonet prapanikë, me të cilët ishin rritur gjatë gjithë jetës, kur shkuan në fillim në hekurudhë, kundërshtuan të laheshin, duke thënë se i paskësh larë Zoti me "ujë të bekuar". Pas punës edukative ato më së fundi u bindën dhe filluan të lahen. Pastaj, këto vajza, nga pastërtia dhe nga puna, ndienin një kënaqësi të tillë shpirtërore dhe trupore, që s'e kishin njohur gjer atëherë dhe brenda një kohe të shkurtër u çelën e u bënë si lule.

Pastërtia nuk është luks, ajo është një nevojë që ka të bëjë me shëndetin e njerëzvet… Ne veprojmë drejt, kur bëjmë përpjekje të realizojmë çdo gjë, po

mendoj se në radhë të parë duhen bërë përpjekje për të trefishuar prodhimin e sapunit.

Vizitova një ditë kooperativën bujqësore të Shijakut, ku midis tjerash, pashë edhe furrën (tani pothuajse kudo në kooperativat tona bujqësore ka furra). Atje kanë tri furra të mëdha, të sistemuara bukur. Po vallë nuk ka mundësi të ngrihet pas furrës një banjë e madhe, e ndarë më dysh, njëra për t'u larë burrat e tjetra për gratë? Për këtë s'mendon njeri. Banjo e lavanderi ndërtohen vetëm në qytete, kurse për këto ka nevojë edhe fshati… Unë mund t'u kujtoj shokëvet që kanë qenë edhe më parë në Tiranë, se si, gratë fanatike tiranase të asaj kohe, me çarçaf në kokë e një bohçe nën sqetull dhe me kalamanët në duar, venin e laheshin në hamamin e vetëm që kishte qyteti. Atëherë, si të mos venë të lahen sot në banjo shijakasit, më parë kalamanët e tyre, pastaj burrat e gratë?" (12 dhjetor 1967. Vep.37, f.155-156)

5."E kam fjalën për çështjen e pastërtisë, e cila ka rëndësi të madhe për jetën e njeriut. Pastërti do të thotë qytetërim, do të thotë shëndet e jo luks… Një nga faktorët e zgjatjes së jetës së njeriut dhe që e bën atë të gëzuar e të kulturuar, është edhe pastërtia… Kryesorja është që mbajtja e pastërtisë të bëhet edukatë e të gjithëvet.

Duhet të dini se në vendin tonë vazhdojnë të na vdesin akoma shumë kalamaj, sidomos në malësi, kryesisht për arsye të papastërtisë… Rrobat mund t'i kemi edhe të vjetra e të arnuara, kjo s'prish punë për shëndetin, mjafton që ato të jenë të pastra. Sapun tani kemi kudo, por edhe po të qëllojë në ndonjë rast që të mos ketë, mund të përdoren në vend të tij, finja, kopani, rëra e çdo mjet tjetër pastrami. Pastërtinë duhet ta vini kudo në rendin e ditës. Të përpiqemi që të futim edhe në fshat zakonin e mirë që, të paktën një herë në javë çdo njeri në familje, kalamanë ose të rritur, të lajë trupin… Janë të gjitha mundësitë që në çdo shtëpi të përgatitet ujë i ngrohtë, me të cilin të lahen tërë pjesëtarët e familjes, se trupi i palarë është i prirur për çdo sëmundje. Veç kësaj, për të ruajtur pastërtinë dhe shëndetin e njerëzvet, çdo vit duhet të lyhen shtëpitë me gëlqere. Rëndësi të madhe ka, gjithashtu, edhe higjiena e ushqimevet." (20 maj 1968. Vep.38, f.90-91)

***6.**"Këtu u tha për përpjekjet që bëhen lidhur me konservimin e ushqimevet për dimër, si: lakrat, turshitë, fasulet, mishi i derrit etj. Mishi derrit me lakrën janë dy ushqime që, të kombinuar me njëri-tjtin, shkojnë shumë mirë dhe japin gjellë të shijshme. Nga ana tjetër, ju duhet të luftoni që, veç lakrës, të prodhoni edhe zarzavate të tjerë. Çdo kooperativë të mendojë seriozisht të mbjellë domate, patëlxhanë, piperka, bamje, kastraveca, kunguj, karota, spinaq, lakër, presh etj. etj. Dhe, në radhë të parë, përpiquni që fshatarët të mësojnë mënyrën e përdorimit e të gatimit të këtyre zarzavateve dhe t'i shfrytëzojnë në ushqimin e tyre, bile me shumicë.* (27 maj 1968. Vep.38, f.165)

7."Natyrisht, çdo organizëm ka veçoritë e tija, ai ka nevojë për lëndë të ndryshme, si: për squfur, për hekur, për sheqerna, për vitamina etj. Disa nga këto lëndë gjenden te mishi, ca të tjera te domatet, të tjera te patatet e kështu me radhë. Çështja s'qëndron vetëm te shija e mirë e këtyre ushqimeve, kryesore është se ato forcojnë shëndetin e njeriut." (27 maj 1968. Vep.38, f.167)

8."Tani mendoj se duhet të keni kujdes që jo vetëm shtëpitë brenda t'i mbani pastër, po tërë fshatin ta zbukuroni, ta pyllëzoni me pemë, të bëni parqe të lulëzuar dhe rrugë të reja. Por, në radhë të parë t'u vini rëndësi pastërtisë dhe higjienës personale, si dhe pastërtisë brenda shtëpisë. Të dyja këto duhet të shkojnë së toku, se janë një nevojë e domosdoshme dhe kënaqësi e njeriut. Më parë njerëzit mendonin se punëtorët dhe fshatarët, kur kthehen nga puna të lodhur, nuk kanë nge të pastrohen. Ky mendim nuk është i drejtë, pse pastërtia e çlodh njeriun, ajo… ruan shëndetin dhe trupin nga shumë sëmundje, duke ia zgjatur jetën njeriut." (6 tetor 1969. Vep.42, f.22)

9."Përpara luftës njerëzit në (RPSSH) vdisnin për një kokërr kininë. Si rrjedhim i punës prej skllavi dhe i varfërisë, jeta e tyre mesatare nuk i kalonte të 38 vjetët. Sot edhe në zonat më të thella, si në atë të Dukagjinit, ka spitale e shtëpi lindjeje. Shtrirja e shërbimit mjekësor në gjithë vendin, ngritja e spitalevet, e klinikavet, e ambulancavet, e infermierivet, shërbimi mjekësor e kurimi falas për gjithë popullsinë dhe përgjithësisht rritja e mirëqenies së punonjësvet e kanë bërë jetën e tyre të lumtur e të sigurt. Tani jeta mesatare e jeriut te ne është zgjatur dhe ka arritur 66 vjet." (28 nëntor 1969. Vep.42, f.174-175)

10.„Inkurajimi më i mirë për rritjen e popullsisë është ngritja ekonomike, prandaj të bëjmë të gjitha përpjekjet për këtë, të punojmë sidomos për forcimin ekonomik të kooperativavet... Në qoftë se arrijmë që kooperativistët të mos marrin nga 5 ose 8 lekë, po nga 16 deri dhe 18 lekë për ditë-punë, ... t'u bëjmë propagandë për higjienën dhe t'u themi gravet të kenë të paktën nga tri palë veshje të brendshme për kalamanët... Mirëpo tashti që marrin të ardhura të pakta, me se t'i bëjnë?" (30 maj 1970. Vep. 43, f.391)

12.„Nevojat tona në këtë fushë nuk përballohen dot me kaq mjekë sa kemi tash, po me mijëra. Partia dëshiron të ketë mjek jo vetëm në çdo kooperativë, por në çdo fshat, të ketë mami, infermierë, farmacistë e të tjerë, që njerëzit të gëzojnë shëndet të plotë." (31 maj 1970. Vep.43, f.414)

13.„Shëndeti, motra dhe vëllezër, ka rëndësi të jashzakonshme. Më falni se do të flas një çikë për këtë çështje, (por) po e theksoj se ka shumë rëndësi. Partia i më shumë kujdes shëndetit të njeriut që kur lind e gjatë gjithë jetës. Synimi i saj është që (njeriu) të rrojë sa më shumë. S'ka asgjë më të çmuar se njeriu, ka thënë Stalini..." (31 maj 1970. Vep.43, f.439)

14.„Një fëmijë që lind është një fitore jo vetëm për mëmën e për babën, por edhe për Atdheun, prandaj, si ndër qytete, edhe ndër fshatra, duhet të tregohet nga të gjithë kujdesi më madh sidomos për kalamanët. Veçanërisht, të dashura motra, kujdes për fëmijët duhet të tregohet në malësi, ku edhe klima është një çikë më e fortë dhe pakujdesia më e vogël i dëmton ata." (31 maj 1970. Vep.43, f.440)

15„Rëndësi të madhe i jep Partia përgatitjes së mjekëvet, të infermierëvet e të mamivet... Unë u rekomandoj atyre të shkrijnë të gjitha forcat e mendjes e të trupit për çështjen e madhe të shëndetit të popullit... Me rastin e epidemisë së gripit, kohët e fundit, ...të gjithë, duke punuar pa pushim, bënë një punë shumë të lavdërueshme. Kjo epidemi e rëndë na erdhi nga jashtë dhe patëm disa humbje, por me masat që morën Partia e Qeveria dhe me kujdesin e madh të mjekëvet, të infermierëvet, të mbarë punonjësvet të shëndetësisë, u arrit që humbjet të ishin mjaft të kufizuara." (31 maj 1970. Vep.43, f.440)

16.„Të mendojmë e të punojmë për shëndetin e gjithë popullit, që të tërë të jenë të shëndetshëm. Partia përpiqet që njerëzit tanë të jenë të fortë, të çeliktë. Me politikën e saj shëndetësore dhe me masat që ka marrë, është arritur të zhduken

epidemitë në vendin tonë... Të bëjmë shumë kujdes për njeriun dhe për të rinjtë, sidomos në periudhën e rritjes dhe të formimit të tyre fizik...“ (31 maj 1970. Vep.43, f.441)

17.„Shteti ka harxhuar dhe harxhon miliona për shëndetin e popullit. Ai ka ngritur spitale e qendra shëndetësore, duke i pajisur ato më së miri me aparatura moderne nga viti në vit dhe ka përgatitur vazhdimisht shumë kuadro. Po, si punojnë e si i shërbejnë ata popullit; ç'punë shkencore bëhet në instituconet shëndetësorë?“ (21 dhjetor 1970. Vep.45, f.68)

18.„Nuk është aspak e mjaftueshme të na thuhet, për shembull, që rakitizmi te fëmijët është kaq për qind, kurse në një rreth tjetër është më i ulët ose më i lartë. Kryesorja është se ç'po bëhet për ta luftuar këtë sëmundje.“ (21 dhjetor 1970. Vep.45, f.69)

19.„Konstatoj se, kur vjen fjala për ruajtjen e shëndetit të popullit, theksi vihet vazhdimisht te shtretërit, kurse mua më duket se kjo nuk është e drejtë. Nuk është numri i shtretërvet kryesorja që do të na përmirësojë shëndetin e njerëzvet tanë. E them këtë se shtrimi nëpër spitale po praktikohet në shkallë të gjërë e pa kritere të shëndoshë, saqë tjetrin, një çikë ta zërë një dhëmbje dhe e dërgojnë drejt e atje. Por edhe në spital, në vend që të rrijë aq ditë sa është e domosdoshme, qëndron shumë më gjatë, në kurriz të shtetit.“ (21 dhjetor 1970. Vep. 45, f.70)

20.„Anëtarë Plenumi, shokë të tjerë Partie dhe punonjës të paorganizuar në Parti, ...mjekë dhe drejtues të institucionevet shëndetësorë... kritikuan rreptë, me të drejtë, shumë mungesa e dobësi që ekzistojnë në (sektorin jetik të shëndetësisë).“ (26 janar 1971. Vep.45, f.189)

21.„Kur të punojmë materialet e këtij Plenumi në Parti, në popull e veçanërisht në institucionet shëndetësorë, si në spitale, klinika, çerdhe etj., të kemi kujdes që të ndihmojmë e të nxitim sa më shumë mendimin krijues të njerëzvet... Të mos kufizohemi vetëm me kritikën e të metavet, të mungesavet e të dobësivet që kanë ekzistuar deri tani, por të mendojmë... për ruajtjen dhe për përmirësimin e mëtejshëm të shëndetit të popullit... ‚Shëndeti në radhë të parë', thotë me të dejtë një fjalë e urtë e popullit (tonë).“ (26 janar 1971. V ep.45, f.190)

22.„Në vendet ku sundon kapitalizmi, ...si për çdo gjë, edhe për çështjen e shëndetit, borgjezia vepron në interes të saj, ... duke shfrytëzuar masat punonjëse... Edhe në këta vende janë marrë disa masa shëndetësore dhe sigurimi shoqëror, por në fakt ato nuk e kanë atë karakter të vërtetë social... Në vendet kapitalistë punëtori ‚skllav' i fabrikës, ose bujku ‚skllav' i tokës së fermerit, kur sëmuret, e ka zor të shohë derën e spitalit apo të klinikës,... sepse (të gjithë shëbimet dhe barërat) i kushtojnë atij jashtzakonisht shumë, i kushtojnë, siç thotë populli, ‚qimet e kokës'." (26 janar 1971. Vep.45, f.191)

23.„Shkenca mjekësore në disa nga vendet kapitalistë ka bërë përparime të mëdhenj, atje ka shkencëtarë, profesorë e mjekë të shquar, ka spitale dhe klinika të mëdha, por të gjitha këto mundësi nuk janë për njerëzit e thjeshtë, për punëtorët, për të varfërit, por vetëm për ata që kanë të paguajnë... Realizimet e mëdhenj të mendjes së njeriut, si në çdo fushë, edhe në atë të mjekësisë, në vendet kapitalistë përdoren për qëllime tregtarë, për pasurimin e borgjezisë në fuqi." (26 janar 1971. Vep.45, f.192-193)

24.„Është turp për njerëzit tanë të ketë sot pisllëk në fshat dhe është e pakuptueshme papastërtia që vihet re sidomos në disa fshatra." (30 mars 1971. Vep.45, f.389)

25.„Javën e kaluar bëra një vizitë në Petrelë dhe pyeta sekretarin e organizatës-bazë të Partisë se kush rrinte në ndërtesën që ishte aty pranë. ‚Është çerdhja', më tha ai, dhe shkuam për ta parë. Po çfarë të shikoje, shokë? Një papastërti në gjithë ambientin. Së pari, këtë e tregonte vetë paraqitja e jashtme e njërës prej grave që punonte aty. Pashë pastaj fëmijët duke ngrënë si mos më keq. Në çerdhe kishte gjithsej 12 fëmijë. E pyeta gruan, përse ishin të vegjëlit në atë gjendje? ‚Jam vetëm', m'u përgjigj, ‚se shoqja tjetër gatuan', megjithëse për të ngrohur qumështin u duheshin vetëm disa minuta. Dy kujdestaret, të cilavet nuk u duhej më shumë se një çerek ore për ngrohjen e qumështit dhe gjysmë ore për të përgatitur makaronat, nuk gjenin kohë t'u lanin duar e faqe kalamanëvet, të pastronin odën ku rrinin ata etj. Ja pra, pse lejohej kjo gjendje në lidhje me pastërtinë?

Pastaj u takova me drejtorin e shkollës dhe e pyeta: 'Po ty, shoku drejtor, çfarë të pengon të kujdesesh pak për çerdhen, të shikosh atje pastërtinë sidomos në

rrobat, në fytyrat dhe në duart e fëmijëvet?‘ ‚Keni të drejtë, shoku Enver‘, m’u përgjigj, por ama vura re se drejtori nuk e kontrollonte as në shkollë pastërtinë.“ (30 mars 1971. Vep.45, f.390-391)

26.„Ju duhet ta organizoni punën në mënyrë të tillë që të vihet në dispozicion, në orar të caktuar, një makinë, për të marrë nënat nga kombinati dhe për t’i sjellë (te çerdhja e fëmijëvet). Makina të presë në oborr 15-20 minuta, aq kohë sa u duhet nënavet për t’u dhënë fëmijëvet të pijnë dhe pas kësaj, menjëherë, pa humbur kohë, të nisen në punë. Në asnjë mënyrë nuk duhen lënë fëmijët pa pirë. Kjo punë duhet të përfundojë sa më parë. Më mirë të mbetet ca prodhimi, se sa të mbeten kalamanët pa pirë. Vetëm se nënat duhet të bëhen të ndërgjegjshme edhe për punën, t’u japin fëmijëvet të pijnë dhe të kthehen shpejt ku i pret autobusi.“ (8 maj 1971. Vep. 46, f.191) (Ngjarja ndodh në Elbasan. Gj.D.)

27.(Në Ekspozitën ***‚Shqipëria 1971‘***)

„ENVER HOXHA: Si jeni, si shkon puna për prodhimin e vaksinavet?

NJË MJEKE: Shumë mirë, shoku Enver! Ne prodhojmë tani pothuajse të gjithë llojet e vaksinavet, me disa përjashtime të vegjël, por po bëjmë përpjekje që t’i prodhojmë edhe ato në vend.

ENVER HOXHA: Po BSZH (vaksinë kundër tuberkulozit, Gj.D.) prodhoni?

MJEKJA: Po, po, të tëra i bëjmë. Edhe ujin e distiluar e prodhojmë.

Pastaj, duke parë në mur një tablo të madhe me fëmijë të shëndetshëm, biseda vazhdoi:

ENVER HOXHA: Të tërë nga ajo fazë kemi kaluar, po me ndryshimin se fëmijët tani janë të lumtur. Koha jonë ishte e mjeruar, kurse koha e sotme është e lumtur për popullin dhe veçanërisht për fëmijët.

Për ambalazhin keni vështirësi?

MJEKJA: Shishet e vogla dhe të gjitha të tjerat si kutitë etj. i bëjmë në vend. Vetëm ampulat nuk i prodhojmë dot akoma.

ENVER HOXHA: Do të vijë koha që t’i prodhojmë edhe ato. “ (7 nëntor 1971. Vep.47, f.356-357)

28.“T’u japim studentëvet të mjekësisë njohuri të plota e serioze për profesionin e tyre, … se në këtë fushë nuk është njësoj si me prodhimin e artikujvet industrialë të prodhimit të gjërë, si të këpucëvet, stofavet, enëvet etj., të cilët, edhe në rast se nuk dalin aq të mirë, fundi i fundit mund t’i hedhim në treg me një çmim më të lirë ose mund t’i zëvendësojmë. Kurse një mungesë përgatitjeje e shëndoshë e me seriozitet të madh e kuadrovet në shëndetësi, përbën një problem të rëndësishëm që na kushton shtrenjtë, se jeta e njerëzvet nuk mund të krahasohet me asgjë.” (26 maj 1972. Vep.49, f.83)

29.“Farmakologjia vërtet ka karakter shkencor dhe barnat e panumërt që ekzistojnë sot, kanë vërtet fuqi shëruese, por s’duhet harruar se në vendet kapitalistë ilaçet prodhohen edhe për qëllime tregtarë e spekullimi… Firmat që i prodhojnë synojnë t’i shesin, për të nxjerrë prej tyre sa më shumë fitime. Nuk përjashtohet që shumë prej tyre janë pa efekt, prandaj, duke mos qenë të përgatitur siç reklamohen, një përdorim i tyre pa i njohur si duhet, apo pa kriter, mund t’i shkaktorjë dëme të rëndë të sëmurit.” (26 maj 1972. Vep.49, f.87)

30.“Le të marrim gjendjen e laboratorëvet. Për pajisjen e institucionevet tanë mjekësorë me laboratorë janë bërë përparime. Mjekësia jonë në këtë drejtim, mund të themi, ka hyrë në rrugën e modernizimit, megjithatë, jemi akoma mbrapa nga objektivi që synojmë të arrijmë.” (26 maj 1972. Vep.49, f.89)

31.“Të punojmë… që edhe mjekët tanë, me disa vjet stazh në punë, të aftësohen sa më parë që diagnostikimin me aparaturë ultramoderne, që i bëjnë një të sëmuri, ta realizojnë dhe ta interpretojnë aq mirë dhe me saktësi sa edhe një mjek i dëgjuar që shërben për 30 vjet me radhë, në një nga klinikat më në zë të Evropës.” (21 shtator 1973. Vep.52, f.117-118)

32.“Pranë uzinavet të mëdha ose kombinatevet, ku ka një përqëndrim të madh punëtorësh, çdo ditë është caktuar nga një mjek… (Partia) lufton që klasa jonë punëtore të jetë e shëndetshme fizikisht, e edukuar dhe e brumosur fort ideologjikisht. Në përgjithësi, gjendja shëndetësore e popullit tonë ka ardhur gjithnjë duke u përmirësuar.” (13 prill 1974. Vep.52, f.340)

33.“Më ka ardhur mirë… në lidhje me rritjen e shëndetshme të fëmijëvet dhe për pakësimin e mortalitetit infantil në shifra nën mesataren e republikës… Kur isha unë i vogël, këtu e 50 vjet përpara, mjekët më të mirë në Gjirokastër ishin dy:

njëri nga fisi i Budajvet, kirurg, i cili rrinte më shumë në Stamboll dhe vetëm nganjëherë vinte nga Turqia për të bërë ndonjë operacion, mjeku tjetër i mirë quhej 'doktor Seloja', mbasi ishte nga fshati me të njëjtin emër." (19 qershor 1974. Vep.52, f.463-464)

34."Çdo aksident që ndodh, duhet të na shqetësojë shumë. Është i dënueshëm indiferentizmi ndaj marrjes së masavet për ruajtjen e jetës dhe të shëndetit të njeriut. Ne nuk mund të kënaqemi vetëm duke regjistruar aksidentet, pa vrarë mendjen për parandalimin e shkaqevet." (27 qershor 1974. Vep.52, f.482)

35."Si janë përpjesëtimet e mjekëvet pediatër me ata të specialitetevet të tjerë? Këtu u tha se për mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës punojnë qindra kuadro… Pse janë më shumë mjekë në qytet, kur dihet se popullsia më e madhe është në fshat?

Arsyeja që u tha këtu se 'në qytet kemi spitalet e pediatrisë' mua më duket se nuk qëndron plotësisht. 'Kemi rehatllëkun në qytet', duhej thënë më drejt, dhe në fshat lejohet të ketë gjithë ato të meta në shërbimin shëndetësor! Sado e hidhur, e vërteta mbetet ajo që është. Fjalët e tua (Të Llambi Ziçishtit, Minister i Shëndetësisë, Gj.D.) ***nuk e ndryshojnë dot realitetin… Pediatri të vejë atje ku është shumica e fëmijëvet dhe jo atje ku ka rehatllëk. Të mos na ndodhë edhe në sektorin e shëndetësisë si në ndonjë sektor tjetër, ku me qindra vetë, mbasi mbarojnë shkollën dhe mbasi kryejnë shërbimin ushtarak, nuk kthehen më në vendin e punës ku ishin…***

T'i vihet efektivisht në ndihmë fshatit për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës e jo vetëm të hidhen parulla për ngushtimin e dallimevet thelbësorë midis qytetit dhe fshatit. Si mund të ngushtohen këta dallime, duke pasur në qytet një nivel jetese edhe shërbim shëndetësor shumë më të mirë sesa në fshat?.. Dështimet dhe lindjet e parakohshme të fëmijëvet janë më të shumta në qytet apo në fshat? Atëherë përse grumbullohen mjekët nëpër qytete? Për këta probleme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shëndetin e nënës dhe të fëmijës, duhet t'i nxjerrim më mirë konkluzionet.

Në ç'masë i përdorin punonjësit e shëndetësisë injeksionet që u bëjnë gravet për të evituar lindjet e parakohshme? Sa prej tyre përdoren në qytet e sa në fshat? I them këto, sepse mjeku i fshatit tonë, si mjek i një vendi socialist, duhet të jetë i

pajisur me gjithçka të nevojshme për të ushtruar profesionin e tij. Prandaj të gjithë mjetet dhe medikamentet e nevojshëm duhet t'ia japim për përdorim edhe fshatit. Sigurisht, diçka edhe fshatit i jepet, por duhet parë sa është kjo 'diçka' në ndihmë të shëndetit që i jepet fshatit në krahasim me qytetin…

Në bazë të ligjit për sigurimet shoqërorë-shtetërorë, gruas punëtore ose nëpunëse, sipas vjetërsisë në punë, i paguhen 70-78 për qind të pagës mesatare mujore të tre muajvet të fundit... Ndërsa në fshat gruaja kooperativiste përfiton më pak. Meqenëse gratë në fshat punojnë në kushte më të vështirë se ato të qytetit, në këtë drejtim duhet menduar thellë, si komunistë, që të bëhen korrigjimet e nevojshëm duke i ngushtuar këto diferenca…

Pushimi dhe ndihma (në të holla) të jepen jo në momentin e fundit, kur gruaja do të lindë, por disa javë para lindjes dhe disa javë pas lindjes, sipas ligjit…

Më kanë thënë se, gjatë vitit 1974, 3100 gra kooperativiste nuk kanë marrë fare leje të shtazënësisë. Pse lejohet një gjë e tillë? Të drejtat që i takojnë me ligj gruas në fshat duhen respektuar medoemos si nga kryesitë e kooperativavet bujqësore, ashtu edhe nga vetë (gratë). Nga ana tjetër, ç'kuptim do të kishte leja që merr gruaja shtatzënë, kur ndodhin raste që ajo …s'punon në kooperativë, por punon gati deri në ditën e lindjes në oborrin kooperativist?

Nuk prishet kooperativa sikur (gratë shtatzëna) të punojnë, ta zëmë, 80-90 ditë më pak dhe për këtë periudhë kohe të paaftësisë të përfitojnë edhe ndihmë materiale…

Në organizimin e ndihmës mjekësore dhe në shpërndarjen e personelit të shërbimit mjekësor kam përshtypjen se nuk po ecet drejt. Ku venë këta mjekë që përgatitni ju, shokë të shëndetësisë? Futen nëpër spitalet e qytetevet, siç janë futur?! Shikojeni këtë punë me sy partie, me sy revolucionar. Ndërtohen spitale të mëdhenj në qytete, duke menduar se këtu do të kurohen edhe qytetarët, edhe fshatarët. Kjo nuk është e drejtë. Këtu në Tiranë duhet të kemi spitale me aparatura speciale, ku të shtrohen të sëmurët rëndë që duhet të kurohen nëpërmjet këtyre aparaturave të veçanta. Të tjerët le të shtrohen në spitalet e rrethevet ku banojnë.

Kemi të dhëna që në shumë raste spitalet tanë të mëdhenj janë kthyer në hotele për disa të vetëquajtur të sëmurë.!.. Njeriu të mos qëndrojë në spital më shumë se sa ka nevojë…

Për t'i ardhur më tepër në ndihmë fshatit, lidhur me parandalimin dhe shërimin e sëmundjevet, të disponohen fonde të posaçëm e të krijohen qendra shëndetësore… Shërbimi shëndetësor në fshat duhet organizuar në këtë ose atë formë jo më pak e më keq se në qytet…Nuk mund të vejë, për shembull, gruaja shtatzënë e fshatit të largët për t'u vizituar në konsultoren e qytetit, duke bërë një udhëtim të vështirë që është i dëmshëm dhe i pamundur për të.

Na përmendni se numri i mamivet është shtuar dhe sot ato shërbejnë në çdo fshat. Mirëpo, janë në gjendje ato që ta trajtojnë e ta ndihmojnë si duhet foshnjën që u vjen në duar? Kanë aftësi ato ta mësojnë nënën për regjimin që duhet të mbajë gjatë barrës dhe lindjes? Ç'ndryshime shihen efektivisht, pas vajtjes së mamivet në fshat, në uljen e dështimevet, të vdekjevet të fëmijëvet, në higjenën e nënës e të fëmijës etj.? Gjithashtu duhet parë si punojnë ato, rrinë e presin vetëm në maternitet, apo janë vajza të gjalla e revolucionare dhe venë në shtëpi për t'u mësuar gravet ato që dinë vetë… (Dhjetë vjet më vonë, më 1986, në fshat shërbenin 2836 mami me arsim të mesëm. Fusnotë, f.197)

Rolin kryesor në këtë fushë e luajnë, vetë nëna dhe opinioni shoqëror në kooperativë… Nëna duhet të bëjë një kujdes të madh ndaj fëmijës jo vetëm para se ajo të lindë, por edhe pas lindjes. Duhet një luftë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme nga ana e Partisë për të mbrojtur nënën dhe fëmijën, që janë burimi i jetës…

Të formojmë koncepte të qartë në kokën e fshatarit, i cili të ketë respektin e duhur për gruan dhe për foshnjën që ajo mban në bark, të kuptojë se ç'duhet bërë që ajo të lindë fëmijë të shëndetshëm dhe ta rritë këtë, gjithashtu, të shëndoshë…Në qoftë se… kur është shtatzënë, merr pjesë në procese pune të tilla, si mblellja e pambukut, prashitja e duhanit etj., ku kërkohet të qëndrojë më shumë në pozicion të përkulur, atëherë gruaja ka rrëzik që fëmijën ta lindë para kohe…

…Nuk shërohet çdo gjë vetëm me ilaçet që përdoren. Kërkohet edhe një edukatë e shëndoshë masive, që t'u kundërvihet mentalitetevet prapanikë dhe të krijojë

një ndjenjë më njerëzore në qëndrimin ndaj gruas, ndaj nënës." (3 mars 1975. Vep.54, f.192-200)

36."Për të ruajtur shëndetin dhe për të kryer mirë gjithë këtë punë të madhe që kemi, pushimi, që këshillon Partia të bëjmë secili e që parshikon ligji, është, natyrisht, i nevojshëm." (2 prill 1976. Vep.57, f.25)

37."Mendoj se caktimi i pensionit më të lartë të pleqërisë në shumën 700 lekë nuk është pak, po të marrim parasysh edhe mesataren që kemi. Pensionisti mund të jetojë shumë mirë me pensionin që do të marrë, se fëmijët e tij, në kohën kur ai mbush moshën, në përgjithësi, janë në marrëdhënie pune ose kanë krijuar familje më vete.

Për çështjen e shpërblimit mbi maksimalen e pensionit, kur pensionisti punon, unë mendoj ta lëmë vetëm 200 lekë, pra, pensioni bashkë me pagën të mos kalojë 900 lekët….

(Fëmija jetim), pensionin që i takon nga prindët e vdekur, e merr vetëm për sa kohë që është i mitur. Kur rritet dhe futet në punë, pensioni i ndërpritet. Në qoftë se ka motra ose vëllezër të vegjël, atëherë, ndryshon puna: këta vazhdojnë të marrin pensionin deri sa të hyjnë në marrëdhënie pune…

Lidhur me propozimin për shpenzimet e ushqimit që duhet të përballojë shteti në kopshtet e çerdhet e kooperativavet bujqësore, në parim, unë jam i mendimit që, për shumë arsye, në fshat duhet të jepet më shumë subvencion se në qytet." (26 prill 1976. V ep.57, f.246-247)

38."Ju thatë se vdekshmëria foshnjore në rrethin tuaj është e lartë në zonën e Moglicës, sidomos në fshatrat Gopesh e Dobroçan. Moglica është si Labëria e Gjirokastrës, kurse Pogoni, Lunxhëria, nuk kanë vdekje në fëmijë. Por s'e kuptoj përse të jetë i lartë mortaliteti i fëmijëvet në Bilisht. Ky është qytet… Po te ju, në Mirditë, si është mortaliteti infantil? Këtij problemi t'i vini kujdes më shumë" (27 tetor 1977. Vep.62, f.308, 311)

39.„Sikur mjekët, për shembull, të ikin çdo mbrëmje në qytet, ‚të çajnë ferrën', si thotë populli, një gjë e tillë mund të ketë pasoja të rënda. Mund të ndodhë që pikërisht natën, një fëmijë të sëmuret e të vdesë, në qoftë se nuk jepet në kohë ndihma e mjekut." (14 mars 1978. Vep.64, f.25)

40.„(Nexhmoja), (Një plak i Gjirokastrës, në kohët para Luftës, Gj.D.) ***interesohej për çdo gjë dhe, njerëzvet që ishin ngarkuar me pastërtinë e qytetit, kur kjo s'ish në rregull, u thoshte: ‚Pse i keni lënë pa fshirë rrugët?' Ose dyqanxhinjvet u tërhiqte vëmendjen: ‚Pse nuk i pastroni xhemat?' „*** (21 mars 1978. Vep.64, f.274)

41.„Në rast se, (ti, shoku Neshet,) (Neshet Hoxha, funksionar në Gjirokastër, Gj.D.) ***shikon që ndonjëri nuk e mban pastër ambientin, se përpara shtëpisë ose në oborr ka plot plehra, gurë, barëra të këqinj etj., t'i thuash atij: ‚Ç'janë gjithë këto papastërti? Nuk m'i jepni mua ca fshesën dhe kazmën, t'jua pastroj?' Me një fjalë, t'i futësh një çikë në sedër ata njerëz. Me siguri, zonjat e shtëpisë, kur të dëgjojnë këto fjalë, menjëherë do të thonë: ‚U! Ç'është kjo? Si ta pastrosh zotrote oborrin tonë? Ne do ta bëjmë vetë këtë punë!' 'Mirë, bëjeni, t'u thuash ti, por herë tjetër të mos jua gjej kështu, se do të kaloj prapë këndej e do të ju kontrolloj.'…***

Banorët (duhet) të shikojnë kujdesin dhe interesimin e Partisë dhe të pushtetit për rregullin, zbukurimin dhe mirëmbajtjen e qytetit." (21 mars 1978. Vep.64, f.275)

42."(Më thanë se) në Ndërmarrjen Bujqësore të Vrinës vdekshmëria e popullatës është tre për mijë. Por me siguri këtu ka zona që e kanë vdekshmërinë edhe më të ulët. Këto përqindje të vdekshmërisë zor se i gjen në vendet e tjerë. Kur bëjmë krahasime me ato të Organizatës së Kombevet të Bashkuar, shohim se kohëzgjatja e jetës te ne është nga më të lartat dhe përqindja e vdekjevet nga më të ulëtat." (25 mars 1978. Vep.64, f.404)

43."Përsa i përket luftës për mbrojtjen e shëndetit të njerëzvet, në vendin tonë janë bërë përparime të mëdhenj. Këta përparime vërehen jo vetëm në faktin që jeta mesatare e njerëzvet tanë është rritur gati dyfish në krahasim me periudhën e Paraçlirimit, por edhe se vdekshmëria e të vegjëlvet te ne është ulur shumë në krahasim me të kaluarën… Kur mendojmë që Gjirokastra, Shkodra, Puka, Elbasani etj., që përpara e kanë pasur të madh numrin e vdekjevet të fëmijëvet, kurse tash kanë bërë përparime të mëdhenj në këtë drejtim, na bëhet zemra mal." (27 mars 1978. Vep.64, f.457)

Për secilin prej këtyre fragmenteve do të mund të bëhej nga një koment i gjatë, qoftë duke e pasqyruar e plotësuar me lëndë shtesë kohën për të cilën bëhet fjalë, qoftë duke e krahasuar me të sotmen. Nuk është aspak fjala, as për "nostalgji", siç shprehen disa sa herë që përmendet "***Koha e Merhumit***", as për të shtrembëruar apo përbaltur kohën në të cilën po jetojmë. Qëllimi është për ta paraqitur historinë me vërtetësi. Por unë nuk po hyj tani në komente, sepse vetë lexuesit do të mund të nxjerrin përfundimet, simbas shkallës së informimit dhe simbas formimit kulturor e arsimor që ka secili.

Gjokë Dabaj, Durrës - 15 prill 2017